



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

A-450/01-0264440/17, më 24. 10. 2017

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për subvencionimin e Shoqatës së familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, dega në Prishtinë.
- II. Shuma e mjeteve financiare që do të ndahet është 1328 € (një mijë e treqind e njëzet e tetë euro), prej të cilave 500 € për transport dhe 828 € për akomodim dhe ushqim.
- III. Shuma e cekur në pikën II të këtij vendimi, i ndahet Shoqatës së familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, dega në Prishtinë, për mbulimin e kostos financiare për transport, akomodim dhe ushqim për disa familje të dëshmorëve në vizitën e organizuar në Kosovë dhe Shqipëri me rastin e 5 Majit – “Ditës së Dëshmorëve të Kombit”.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës.
- V. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kërkesa e Shoqatës dhe faturat me nr. 155/17, 143/17.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- SH.F.D e UÇK-së, dega në Prishtinë;
- Drejtorisë së Financave;
- Qendrës për Shërbime me qytetar;
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS
Spend Ahmeti